

MATILDA PARLLAKU

VEÇORI GJUHËSORE NË TEKSTET LIGJORE

Hyrje

Objekt i këtij studimi janë studimi i disa çështjeve gjuhësore, morfologjike dhe sintaksore që u japin “pushtet” teksteve ligjore, në kuptimin e realizimit të atyre tipareve që duhet të zotërojnë një tekst ligjor për të qenë i kuptueshëm dhe lehtësisht i zbatueshëm: saktësia, qartësia dhe pastërtia gjuhësore.

Qëllimi është të vihet në dukje rëndësia që ka aspekti gjuhësor, jo vetëm në formulimin e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tyre, por edhe për të kuptuarit dhe zbatimin e tyre në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore gjatë proceseve gjyqësore: mosmarrëveshje, apo konflikte, për të cilat shërbejnë si referencë.

Gjatë hartimit të këtij studimi kemi ndjekur metodologjinë e krijimit të një korpusi të përbërë nga Kushtetuta dhe disa nga kodet që zbatohen në Shqipëri: Kushtetuta e RSH, Kodi Civil (më poshtë KC), Kodi Penal (më poshtë KP), Kodi i Familjes (më poshtë KF), Kodi i Procedurës Civile (më poshtë KPC), Kodi i Procedurës Penale (më poshtë KPP).

Në kuptimin e gjerë një **ligj** është një dispozitë normative që vendos një rregull juridike për aplikim të detyrueshëm. Dallojmë nga njëra anë ligjet kushtetuese që përcaktojnë të drejta themelore, organizimin e pushteteve publike dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, ligjet organike që ndërtojnë institucionet e Republikës.¹

Një **kod** paraqitet si një tërësi dispozitash normative, të bashkuara në një vepër, të cilat paraqesin një vijimësi logjike të librave, titujve, kapitujve, seksioneve, ndonjëherë edhe nënseksioneve, paragrafëve dhe në fund neneve. Kodet përmbajnë ekskluzivisht tekste të ligjeve ose të rregulloreve që kanë një përmbajtje zyrtare. Tekstet speciale, tekstet e shfuqizuara, komentaret, bibliografitë, referencat ndaj doktrinaeve dhe ndaj jurisprudencës që botuesit fusin në tekst ose në vijim të neneve të kodeve, nuk kanë fuqinë e ligjit.²

¹ *Au sens large, une "loi" est une disposition normative et abstraite posant une règle juridique d'application obligatoire. On distingue d'une part, les lois constitutionnelles qui définissent les droits fondamentaux, fixent l'organisation des pouvoirs publics et les rapports entre eux, les lois organiques qui structurent les institutions de la République et pourvoient aux fonctions des pouvoirs publics* Dictionnaire du droit privé, Serge Braudo, © 1996-2015 Serge Braudo, Conseiller honoraire à la Cour d'Appel de Versailles et Avocat au Barreau de Paris, <http://www.dictionnaire-juridique.com/definition/code.php>, konsultuar për herë të fundit dt. 13.11.2015.

² “Un Code se présente comme un ensemble de dispositions normatives, placées dans un ouvrage présentant dans une même reliure une suite logique de Livres, de Titres, de

Një kod mbledh dhe inkorporon të gjitha dispozitat ligjore vendase në fushën e caktuar. Në disa raste, dispozitat e tij mund të pasqyrojnë edhe detyrime ndërkombëtare ose evropiane. Kjo e lejon kodin që të jetë homogjen dhe i qartë.³

Janë zgjedhur kodet si lloj i teksteve ligjore për t'u konsultuar, pikërisht për arsye se janë tërësi, përmbledhje ligjesh, ose ligje të cilat kanë kaluar procesin e kodifikimit⁴). Konsultimi i këtyre teksteve u bë me qëllimin e konstatimit të çështjeve për të cilat interesohemi dhe puna vijoi më pas me nxjerrjen prej tyre, të shembujve konkretë për t'u përdorur gjatë analizës dhe përfundoi me përqendrimin mbi një çështje ngushtësisht sintaksore atë të përdorimit të disa lokucioneve lidhëzore kushtore në këto tekste.

Çështjet që do të trajtohen gjatë punimit:

1. Këndvështrimi specifik i korpusit të zgjedhur për studim;
2. Karakteristika të përgjithshme të teksteve ligjore;
3. Veçori gjuhësore të teksteve ligjore;
4. Përdorimi i lokucioneve lidhëzore kushtore në këto tekste;
5. Përfundime

1. Këndvështrimi specifik i korpusit të zgjedhur për studim

Ligji është marrëveshje e vendosur nga një bashkësi njerëzish, së cilës i nënshtrohen të gjithë njerëzit që direkt apo indirekt kanë marrë pjesë në hartimin e tij. Ligjet parashikojnë norma dhe veprojnë brenda kufijve të caktuar kohorë. Kodet nga ana tjetër përmbledhin normat dhe parashikohen të kenë njëfarë qëndrueshmërie, të jenë koherente dhe të qarta.⁵

Ligjet mund të jenë *penale* (që sanksiojnë ndëshkimin në rast sjelljeje anti-shoqërore), *civile* (që lejojnë padi ndërmjet personave me aftësi juridike për të vepruar, p.sh.: për dëme apo kërkimin e një urdhri nga gjykata për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi të caktuar), *kushtetuese* (që krijojnë bazën juridike për funksionimin e një shteti, duke përfshirë zakonisht të drejtat dhe liritë e njeriut në një seksion të veçantë).

Chapitres, de Sections, quelque fois de Sous-sections de Paragraphes et enfin, d'articles. Les Codes contiennent exclusivement des textes de lois ou de règlements ayant une teneur officielle. Les textes spéciaux, les textes abrogés, les commentaires, les bibliographies, les références de doctrine et de jurisprudence que les éditeurs insèrent dans le texte ou à la suite des articles des Codes qu'ils éditent, n'ont pas force de loi." Po aty.

³ Manual i hartimit të ligjeve, një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, botim i mundësuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit CARDS të BE-së për Shqipërinë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Misionin Evropian i Asistencës për sistemin shqiptar të drejtësisë EURALIUS, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Pegi, Tiranë, 2010, f. 48.

⁴ *Koncepti formal i kodifikimit është ai i konsolidimit që synon grumbullimin e dispozitave ekzistuese ligjore në një formë të caktuar, por pa ndryshuar thelbin e dispozitave. Kodifikimi është një veprimtari që synon të përgjigjet ndaj kompleksitetit të ligjeve ose legjislacionit në përgjithësi, duke lehtësuar përdorimin e normave.* Po aty, f. 44-45.

⁵ Po aty, f. 44.

Këto tekste ligjore: *ligje, dekrete, vendime, kode, rregullore, udhëzime, urdhra* etj. nga një vështrim asnjans janë thjesht dhe vetëm mjete ndihmëse, të cilave u referohen profesionistët e së drejtës për të zgjidhur çështje të caktuara gjatë praktikës gjyqësore. Në një vështrim më specifik, nga pikëpamja teknike e hartimit të tyre, merren hartuesit, persona të specializuar për këtë qëllim. Nga këndvështrimi i përkthyesit dhe sidomos i gjuhëtarit, këto tekste nuk shihen vetëm në anën formale të tyre, por edhe nga ana përmbajtësore dhe me synimin e të kuptuarit të domethënies që transmetojnë ato, nëpërmjet mjeteve gjuhësore.

Sa i takon këndvështrimit të përkthyesit, tek i cili nuk do të ndalemi këtu, ai i sheh këto tekste ligjore në aspektin e përshtatjes së terminologjisë së duhur me tekstin origjinal, si edhe në atë të besnikërisë në përkthim duke mbajtur parasysht ruajtjen e strukturave sintaksore të ndërtuara nëpërmjet bashkëveprimit të mjeteve morfologjike.

Ndërsa gjuhëtari (dhe jurilinguisti-personi që i studion në cilësinë e juristit dhe gjuhëtarit të diplomuar, siç do t'i shohim në këtë studim) i lexon dhe i shqyrton këto tekste me një synim më të thellë, jo vetëm për t'i kuptuar në përmbajtje, por edhe si subjekt i analizës më të thellë gjuhësore. Ai interesohet veçanërisht për mënyrën e strukturimit të tyre nga ana gjuhësore dhe për rolin që ato luajnë në transmetimin e kuptimit për arritjen e qëllimit për të cilin janë hartuar.

2. Karakteristika të përgjithshme të teksteve ligjore

Një nga kategoritë e teksteve të stilit të veprimtarisë shtetërore e administrative është teksti ligjor (që përfshin ligj, dekret, vendim, urdhëresë, urdhër, kod, udhëzim, rregullore).

Ligjet hartohen nga hartuesit e ligjeve si personat e ngarkuar për të formuluar ligje të ndryshme, në fusha specifike, siç janë gjithashtu edhe nëpunësit civilë dhe disa zyrtarë të shtetit që janë përgjegjës për planifikimin e politikave legislative dhe zbatimin e reformës ligjore.⁶

1. Struktura e ligjeve nuk duhet të jetë një mozaik logjik, por duhet të përputhet me mënyrën normale të menduarit të një qytetari me nivel mesatar intelektual;

2. Konceptet ligjore duhet të shprehen me fjalë që janë sa më të mirëpërcaktuara që të jetë e mundur, në mënyrë që të mos lihet vend për interpretime alternative. Është gjithashtu e rëndësishme që dispozita të tilla të hartohen sipas parimeve të sigurisë ligjore dhe të parashikueshmërisë së ligjeve;

3. Rregullat e përgjithshme nuk duhet të ngarkohen me shumë përjashtime, kufizime ose shmangie;

⁶ Manual i hartimit të ligjeve, një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, botim i mundësuar nga Bashkimi Europian, në kuadër të programit CARDS të BE-së për Shqipërinë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Misionin Europian i Asistencës për sistemin shqiptar të drejtësisë EURALIUS, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Pegi, Tiranë, 2010, f. 11.

4. Qartësia gjuhësore e tyre i bën lehtësisht të lexueshme dhe më të kuptueshme. Ligji duhet të ekuilibrojë saktësinë me kuptueshmërinë.⁷

Stili i ligjeve sa i thjeshtë aq edhe i komplikuar, duhet të jetë i kuptueshëm në çdo ndarje e nëndarje të tij, po aq sa në tërësinë e tij. Karakteri politik, shfaqet në faktin që gjithçka bëhet në emër të shtetit dhe vihet në funksion të përditshmërisë së secilit prej nesh. Ligjet janë të dobishme, sepse përcaktojnë rregulla bashkëjetese dhe norma bashkëveprimi mes pjesëtarëve të gjithë komunitetit me qëllime të qarta pozitive dhe me parashikime sanksionesh për ata që, duke mos i respektuar, cenojnë këtë harmoni drejtpërdrejt ose tërthorazi. Toni i këtyre teksteve është i përmbajtur, korrekt, madje i ftohtë.⁸ Ligjërata shtetërore është një ligjëratë imponuese, pavetore..⁹

Një karakteristikë tjetër që i dallon këto tekste është mënyra e strukturimit të tyre në *nene*, *paragrafë* e *nënparagrafë*, si edhe vendosja e titujve para secilit prej tyre duke pasur për qëllim lehtësimin e leximit dhe, përmes tij, edhe përcjelljen e kuptimit.

3. Veçori gjuhësore të teksteve ligjore

Ajo që duhet të kuptojmë që në fillim të paraqitjes së specifikave gjuhësore të një teksti ligjor është konstatimi dhe diskutimi rreth çështjes së vënies së gjuhës në funksion të komunikimit. Në këtë rast është pikërisht gjuha e shkruar ajo që vihet në funksion të komunikimit dhe kjo është arsyeja që duhet të jetë sa më e pastër e më e saktë, për ta realizuar funksionin e saj.

Funksioni stilistik i ligjërimit të këtyre teksteve është kumtues dhe parashkrues, duke e bërë të detyrueshëm zbatimin e tyre. Tekstet ligjore shkruhen duke u kujdesur më shumë që të mos keqkuptohen, sesa që të kuptohen, thotë Xh. Lloshi.¹⁰

Synohet për thënie të plota, me paraqitje objektive, [...] që kërkojnë të parashikojnë të gjitha anët, të ngjeshin në një vend rrethanat, në marrëdhëniet e tyre logjike dhe me përfundimin e parashkrimit përkatës.¹¹

Fakti që këto tekste ligjore, këto marrëveshje njerëzore nxirren në emër të shtetit e miratohen prej tij duke u kthyer në detyrim për t'u zbatuar nga i gjithë populli, e bëjnë të domosdoshme pastërtinë gjuhësore dhe korrektesën gramatikore si edhe shpjegimin e hollësishëm, nëpërmjet koncizitetit të shprehjes, për të shmangur çdo lloj ambiguiteti.

Disa nga veçoritë gjuhësore të këtyre teksteve, ku komunikimi gjuhësor është i kufizuar në formën e shkruar, veçori që janë të detyrueshme për t'u mbajtur parasysh gjatë hartimit të tyre janë:

⁷ Po aty, f. 82-83.

⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, botimi i dytë, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 205.

⁹ Po ai, po aty, f. 206.

¹⁰ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, botimi i dytë, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 204.

¹¹ Po ai, po atje, f. 207.

1) përdorimi i frazave të shkurtra, jo të ndërlikuara, që të sigurojnë qartësinë e çështjes a të konceptit që shprehin dhe lehtësinë e të kuptuarit të përmbajtjes. Ruajtja e rendit të drejtë, jo neutral dhe pa inversion të gjymtyrëve kryesore apo të dyta në fjali e në fraza të tërësi, mundëson të kuptohet domethënia e saj dhe shmanget zgjatja e panevojshme si në shembullin:

Në qoftë se për shkaqe të justifikuara është e vështirë marrja e provës në gjykim ose për shkak të rëndësisë së saj ose të natyrës së saj ekziston rreziku të humbasë ose të dëmtohet, gjykata mund të urdhërojë të verifikohet shkresa nga një anëtar i trupit gjykues ose të kontrollohet me letërporosi nga gjykata e vendit ku ndodhet shkresa ose të lejojë të merret fotokopje ose fotografia e vërtetuar. (KPC, neni 252)

Në raste të tilla, kur fraza është e zgjatur, do të ishte më mirë që ajo të ndahej në disa fjali, sipas idesë që transmeton.

2) Është mirë që në këto lloj tekstesh të përdoret stili rrëfyes, në vend të stilit referues, për efekt të thjeshtësisë së gjuhës dhe për të pasur një tekst më të lehtë për t'u kuptuar:

*Afati për bërjen e deklaratave, **depozitimin** e dokumenteve ose për **kryerjen e veprimeve** të tjera në gjykatë **konsiderohet** i mbaruar në momentin kur, sipas rregullit, zyrat mbyllen për publikun. (neni 144, pika 5, KPP)*

Në përbërje të këtyre teksteve stili i rënduar vihet re në praninë e strukturave të tilla, të cilat mund të thjeshtëzoheshin. Fakti që janë struktura sintaksore paralele që përsëriten në të njëjtin nen dhe ku ka shmangie nga norma gjuhësore në përdorimin e ndonjë foljeje (*disponon*) që nuk mund të vendosë lidhje me emrat që vijnë para e pas saj (*vendimin dhe detyrimin*), përveçse e rëndojnë stilin, e bëjnë edhe më të vështirë për t'u kuptuar, sepse lexuesi humbet në mes të fjalive të zgjatura pa arsye:

Me vendimin që disponon ndalimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos qëndrojë në një vend të caktuar dhe të mos shkojë atje pa autorizimin e tij. Me vendimin që disponon detyrimin e qëndrimit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet pa autorizimin e saj nga territori i komunës ose bashkisë ku qëndron zakonisht. (neni 235, 1,2, KPP)

3) Vihet re prania e shtuar e emrave prejfoljorë të formuar me prapashitesën kryesisht –im që tregojnë veprim, gjendje ose rezultat veprimi, të cilët e rëndojnë tekstin dhe e bëjnë më abstrakt: *qëndrimin, përcaktimin, vlerësimin, përjashtimin, mosrespektimin, verifikimin, vlerësimin, vendimin, mosfillimin, pezullimin, verifikimin, procedimin, kallëzimin, detyrimin, kundërshtimin, pretendimin, identifikimin, konfirmimin, deponimin, shoqërimin, refuzimin, paralajmërimin, mospranim, pëlqim.*

4) Forma joveprore e foljes ndihmon të kuptohet se në ç'mënyrë merr pjesë kryefjala në veprimin e kryer nga folja. Ajo shërben për të vënë theksin mbi rezultatin e veprimit ose mbi elementet/personat që e pësojnë veprimin. Në tekste kjo formë e foljes përdoret për të treguar një këndvështrim neutral dhe është e rekomandueshme të shmanget, sa më shumë të jetë e mundur dhe të zëvendësohet

me formën veprorë, që e tregon më të qartë kufizimin apo detyrimin për personin që ka një detyrim të caktuar.

5) Shenjat e pikësimit janë mjaft të rëndësishme për t'u respektuar, sidomos presja, në rastin e gjymtyrëve të veçuar që vendosen mes presjesh dhe mund të shkaktojnë keqkuptime, por më e rëndësishme është të mbahet parasysh që ato të shërbejnë vetëm si përforcuese të kuptimit dhe jo si shprehëse të mirëfillta të tekstit ligjor.¹² Duhet shmangur pikëpyetja, pikëçuditja, viza ndarëse, kllapat, shenjat e ndryshme si ajo e paragrafit apo e përqindjes etj.

6) Folja me vlerë modale duhet shoqëron disa folje për të ndërtuar një kallëzues të përbërë dhe, në varësi të fjalisë ku përdoren mund të tregojnë veprim të detyrueshëm, të nevojshëm apo të domosdoshëm. Për këtë arsye duhet bërë kujdes në përdorimin e saj për të shmangur paqartësitë në tekst.

Këto janë gjedhet (modelet e strukturave sintaksore) e sintaksës më të ndërlikuar librorë, me periudha të mëvetësishme, por të rënduara, me lidhje të theksuara të gjymtyrëve, me fjali përcaktore dhe shpesh me kuptime shtrënguese e parashikuese-hipotetike.¹³

4. Përdorimi i lokucioneve lidhëzore kushtore në këto tekste

Ligji, përveç përcaktimit të qartë të normave të përgjithshme, vendos edhe sanksione pikërisht për ata që, duke mos i njohur ligjet ose duke mos dashur t'i zbatojnë ato, bëhen subjekt i ndëshkimit prej këtyre sanksioneve.

Në paraqitjen e normave kushtore zbatohet pikërisht kushtëzimi sipas të cilit: “*në qoftë se*” + “kushti” *atëherë* “rezultati”. Ky rezultat është pasojë e kushtit të plotësuar që shprehet në fjalinë e nënrenditur dhe që ka shërbyer si pikënisje.

Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit, në qoftë se është i pranishëm. (neni 208, pika 3, KPP)

Për ta përforcuar këtë kusht, para lokucionit lidhëzor mund të vendoset edhe një pjesëz përforcuese *vetëm*, duke e kufizuar në këtë mënyrë kushtin vetëm në Këto janë periudhat kushtore të mirëfillta, me të cilat formulohen ligjet e ndryshme natyrore e shoqërore që shprehin kushtëzim midis fakteve dhe dukurive të realitetit.

Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre. (neni 403, KPC)

¹² Manual i hartimit të ligjeve, një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, botim i mundësuar nga Bashkimi Europian, në kuadër të programit CARDS të BE-së për Shqipërinë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Misionin Europian i Asistencës për sistemin shqiptar të drejtësisë EURALIUS, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Pegi, Tiranë, 2010, f. 113.

¹³ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, botimi i dytë, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 207.

Veçoritë semantiko-strukturore të lidhëzave e të lokucioneve lidhëzore u japin periudhave struktura të caktuara dhe ngjyrimë kuptimore të shumta.

Duke u nisur pikërisht nga funksioni kryesor i këtyre *lidhëzave e lokucioneve kushtore*, që është shprehja e marrëdhënieve semantiko-sintaksore ndërmjet fjalive në periudhë, në këtë studim do të sjellim shembuj për përdorimin e disave prej tyre, të përdorura në tekstet ligjore të marra në shqyrtim.

Në qoftë se:

Lokucioni lidhëzor ***në qoftë se*** është i ndërtuar nga forma foljore e kohës së tashme të mënyrës dëshirore të foljes *jam* të vendosur mes dy lidhëzave nënrenditëse njëra kushtore – ***në*** dhe tjetra ftilluese – ***se***. Me lidhëzën ***në qoftë se*** përdoren edhe mënyra të tjera, por në periudhat me fjali të nënrenditur me lokucionin kushtor ***në qoftë se*** që përdoren në stilin administrativo-juridik (nëpër formulime ligjesh), siç janë fjalitë kushtore të mirëfillta, përdoret kryesisht mënyra dëftore. Kjo vjen për shkak të kushtëzimit që në këto lloj tekstesh të përdoret mënyra dëftore dhe në shumicën e rasteve koha e tashme, në mjaft raste me kuptimin mbarëkohor (që ka vlerë të gjithëkohshme), sepse ajo e paraqet si të vërtetë veprimin e emërtuar nga folësi

Ato përmbajnë një kusht të mundshëm ose të pamundshëm në çastin e ligjërit. Ndërtohen me mënyrën dëftore dhe me kushtoren. Kur shprehin një kusht të mundshëm, zakonisht fjalitë kushtore me ***në qoftë se*** marrin si kallëzues një folje që mund të jetë në të gjitha kohët e mënyrës dëftore, por më tepër në të tashmen edhe në të ardhmen:

Në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, ***në rast se*** pjesa që anulohet është aq e rëndësishme saqë, pa të, akti nuk e realizon qëllimin e tij. (neni 117/3, KPA)

Përdorimi i mënyrës dëftore tregon që folësi e paraqet si të vërtetë veprimin e emërtuar nga folja e fjalisë së nënrenditur kushtore, çka e bën të vërtetë e të sigurt edhe veprimin e foljes e të fjalisë kryesore në periudhën me fjali të nënrenditur kushtore.

Në qoftë se sendet e lëna peng ose hipotekë humbasin ose zhvlehtësohen, pagesa e shumave, për të cilat detyrohen siguresit ose të tretët që përgjigjen për zhdëmtimin, nxirren nga pagesa e kredive që lidhen me pengun ose hipotekën, përveç rastit kur ato përdoren për të ndrequr humbjen ose zhvlehtësimin e sendeve. (neni 535, KC)

Në rast se

Ky lokucion lidhëzor është i ndërtuar nga emri ***rast*** në trajtën e pashquar në rasën kallëzore, i prirë nga parafjala e rasës kallëzore ***në*** dhe i ndjekur nga lidhëza ftilluese ***se***.

Lokucioni lidhëzor ***në rast se*** për pasojë dhe fjalitë e ndërtuara me të, janë realtivisht të reja në gjuhën shqipe.

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, pas pesë ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor, duke thirrur debitorin, bën një vlerësim të ri dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit. (neni 557, KPC)

Ndërtimet me **në rast se** e kanë të theksuar karakterin rastësor të supozuar të vërtetimit të kushtit sesa fjalitë me **në qoftë se** dhe e kanë të shprehur më qartë supozimin, dyshimin për realizimin e kushtit, rastësinë e vërtetimit të tyre. Kohët e përdorura në ndërtimin e fjalive të kësaj periudhe e bëjnë kushtin të mundshëm për t'u realizuar.

Në rast se edhe në votimin e katërt asnjëri prej dy kandidatëve nuk ka marrë shumicën e kërkuar, **bëhet** një votim i pestë. (neni 87, Kushtetuta e RSH)

Një e veçantë tjetër në lidhje me kuptimin më të theksuar kushtor, që vjen për shkak të emrit në përbërje të lokucionit është edhe fakti që, kur ky emër në trajtën e pashquar kthehet në trajtën e shquar, e bën më të qartë kushtin që është një dhe i vetëm: *përmbajtja e fjalisë drejtuese që i paraprin së nënrenditurës.*

Në rast se në kontratë është vendosur kushti i ekskluzivitetit në favor të furnizuesit, pala tjetër nuk mund të përfitojë furnizime të të njëjtit lloj nga të tretët dhe as mund të realizojë, me mjetet e veta, prodhimin e sendeve që formojnë objektin e kontratës, në qoftë se për këtë nuk ka marrëveshje të kundërt ose kur në ligj disponohet ndryshe. (neni 779, KC)

Me kusht që

Lokucioni **me kusht që** është relativisht i ri në gjuhën shqipe, rrjedhimisht të reja janë dhe fjalitë e ndërtuara me të. Shprehin modalitet të mundësisë. Folja e fjalisë së nënrenditur është në mënyrën lidhore.

E drejta për të dhënë dorëheqjen është e garantuar, por me kusht që të jetë paraqitur së paku gjashtë muaj para mbarimit të vitit kalendarik ose brenda afatit të parashikuar në statut. (neni 48, KC)

Fjalitë me lokucionin **me kusht që**, e kanë të theksuar kuptimin kushtor nëpërmjet një elementi leksikor (fjala kusht) që merr pjesë në përbërjen e lokucionit lidhëzor.

Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë. (neni 103, KPP)

Ky tip fjalie dallohet nga fjalitë e tjera kushtore me lidhëza e lokucione lidhëzore më të zakonshme. Vendosja gjithmonë pas fjalisë drejtuese, tregon se ky lokucion nuk e ka fituar ende zhërvjelltësinë e një lidhëze kushtore.

Regjistrimi i një kredie në para që sjell kamatë, bën që kamata të qëndrojë në të njëjtën radhë përparësie me atë, me kusht që kamata të jetë përcaktuar në regjistrim. (neni 577, KC)

Fjalja drejtuese e ka mjaft të dobët kuptimin e pasojës, ndërsa fjalja e varur ka më tepër një kuptim kufizues. Kuptimi kushtor është më i qartë, kur veprimet e të dyja fjalive, fjalisë së varur dhe fjalisë drejtuese, i referohen së ardhmes.

Përfundime

1. Tekstet ligjore: *ligje, dekrete, vendime, kode, rregullore, udhëzime, urdhra* janë një nga kategoritë e teksteve të stilit të veprimtarisë shtetërore e administrative dhe kanë tiparet e këtij stili.

Veçori gjuhësore në tekstet ligjore

2. Kodet janë një tërësi dispozitash normative, të bashkuara në një vepër, të cilat paraqesin një vijimësi logjike të librave, titujve, kapitujve, seksioneve, ndonjëherë edhe nënseksioneve, paragrafëve dhe neneve.
3. Ne studiuam rolin që luajnë disa çështje gjuhësore, që u japin “pushtet” teksteve ligjore, për realizimin e kuptueshmërisë dhe zbatueshmërisë së tyre, siç janë: saktësia, qartësia dhe pastërtia gjuhësore.
4. Fjalitë e këtyre teksteve janë rastet e sintaksës më të ndërlikuar librore, me periudha të mëvetësishme, por të rënduara, me lidhje të theksuara të gjymtyrëve, shpesh me kuptime shtrënguese e parashikuese-hipotetike.
5. Lokucionet lidhëzore kushtore janë rasti “*par excellence*” i shprehjes së kushtëzimit në normat kushtore të teksteve ligjore, ku rezultati (rasti juridik në shqyrtim) është pasojë e kushtit të realizuar (shkelja ligjore).

Burime të të dhënave gjuhësore:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, *Miratur me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994.*
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë *botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* shtator, 2003.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, *Miratur me ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995 dhe ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10.4.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, ndryshuar me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ndryshuar me ligjin nr. 9017, datë 6.3.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9030, datë 13.3.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004, ndryshuar me ligjin nr. 9275, datë 16.9.2004 Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor, 2004.*
- Kodi i Procedurës Administrative *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Dhjetor, 2003.*
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë i azhurnuar deri në Shkurt 2004, bashkë me praktikën gjyqësore *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Shkurt, 2004.*
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (*Miratur me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998 dhe nr. 8491, datë 27.5.1999 dhe nr. 8335, datë 18.10.1999 dhe nr. 8812, datë 17.5.2001 Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Mars, 2002.*
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, Tetor, 2003.*
- Manual i hartimit të ligjeve, një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, botim i mundësuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të programit CARDS të BE-së për Shqipërinë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Misionin Evropian i Asistencës për sistemin shqiptar të drejtësisë EURALIUS, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Pegi, Tiranë, 2010, *ndryshuar me ligjin nr. 8536, datë 18.10.1999 dhe nr. 8781, datë 3.5.2001. Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare Shtator, 2003.*

BIBLIOGRAFI

- Gramatika e gjuhës shqipe* 1, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Tiranë, 2002.
- Gramatika e gjuhës shqipe* 2, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Tiranë, 2002.
- M. Lambertz, *Periudha hipotetike në gjuhën shqipe*, përkthyer nga V. Dashi dhe përgatitur për botim nga T. Topalli dhe E. Malaj, Botimet Albanologjike, Tiranë 2011.
- M. Parllaku, *Marrëdhëniet kushtore në gjuhën shqipe, Monografi*, Botimet Jozef, Durrës, ISBN 978-9928-189-63-9, Tiranë, 2015.
- S. Mansaku, *Format e shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, SF, 1969/3.
- Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, botimi i dytë, SHBLU, Tiranë, 2001.